

JANI SOTA

**LUFTA KUNDËR ANALFABETIZMIT NË RRETHIN E FIERIT
(1945-1955)**

Në fund të Luftës II Botërore, Shqipëria dallonte për nivele të larta të popullsisë analfabete, rrjedhje kjo e prapambetjes së theksuar social-ekonomike të trashëguar. Zgjidhja sa më e shpejtë e këtij problemi me karakter demokratik përbënte një nga kushtet e rëndësishme për ecurinë e vendit drejt progresit. Likuidimi i analfabetizmit për pjesën më të madhe të popullsisë u realizua gjatë dhjetëvjeçarit të parë të pasluftës. Në ecurinë e këtij procesi u evidencuan dy faza, *faza e parë* që rroku vitet 1945-1949, kur ai kishte tiparet e një lëvizjeje kryesisht vullnetare nën kontrollin e shtetit dhe *faza e dytë*, 1949-1955, kur u kalua drejt rrugës ligjore. Gjatë zgjidhjes së këtij problemi të madh shoqëror, krahas dukurive të përgjithshme në shkallë vendi, u vërejtën edhe specifika rajonale që meritojnë vëmendje. Nisur nga ky këndvështrim, analiza e procesit në një nga zonat e njohura siç ishte ajo e Fierit, na duket me interes.

*

* *

1. Faza e parë e luftës kundër analfabetizmit (1945-1949)

Ngritja e nivelit kulturor e arsimor të popullsisë dhe në këtë kuadër, lufta kundër analfabetizmit kishte qenë dhe mbetej aspiratë dhe pikësynim i qarqeve përparimtare dhe intelektuale të vendit që në fillim të shek. XX. Shoqëritë patriotike kulturore e bënë pjesë të programeve të tyre. Kështu, shoqëritë “Bashkimi” dhe “Atdheu” në Fier arritën me shumë përpjekje që, në vitet 20 të organizonin grupe mësimi dhe shkolla mbrëmje, si në: Ardenicë, Libofshë, Zharrezë, Vanar etj. Në këtë drejtim rol të rëndësishëm gjatë kësaj periudhe, luajtën mësuesit patriot, si: Llazar Bozo, Elmaz Boce, Anastas Laska, Jorgji Dharmo dhe veçanërisht

Jani Minga, të cilët me përkushtim e plot dëshirë bënë të gjitha përpjekjet e tyre për të përhapur kudo rrezet e diturisë për popullin fierak. Luftën kundër analfabetizmit, qeveria e Nolit e vuri në program si një nga pikësynimet e të ardhmes ndonëse për shumë arsye që njihen nuk u arrit të realizohej. Në qeverinë e Zogut ky problem u trajtua, por më tepër u mbajt i ngritur nga mësues të zonës, të cilët në vitin 1937-1938 mundën të fusnin në kurse një numër të kufizuar myzeqarësh.

Gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, ndonëse në kushte të vështira, u vu në program mësimi i shkrim-leximit tek luftëtarët. Kurset kundër analfabetizmit të hapura në këtë periudhë krijuan mundësi për mësimin e shkrim-leximit edhe nga gratë dhe vajzat, ku krahas programit mësimor bëheshin biseda dhe mësoheshin këngë patriotike¹. Njëheri iu kushtua vëmendje zhdukjes së analfabetizmit në radhët e rinisë në qytete dhe në fshatra. Të rinjtë që kishin arsim ose edhe ata që dinin shkrim-lexim dhanë kontribut si në hapjen e shkollave në çdo zonë të liruar, ashtu edhe në organizimin e kurseve kundër analfabetizmit.

Më vonë organet e reja të pushtetit nxorën udhëzime dhe qarkore të veçanta, në të cilat krahas hapjes së shkollave shtrohej edhe detyra e organizimit të luftës kundra analfabetizmit dhe për krijimin e kushteve për hapjen dhe funksionimin e rregullt të kurseve etj.² Kështu, si një nga qarkoret më të rëndësishme që jepte udhëzime në këtë drejtim mund të përmendet ajo me Nr.4, datë 15 gusht 1944, lëshuar nga Dikasteri i Arsimit³. Ky dokument udhëzonte këshillat nacionalçlirimtare të qarqeve në lidhje me çeljen e shkollave dhe të kurseve për ata që nuk dinin të shkruanin e të lexonin. U bëhej thirrje të rinjve dhe të rejave, që nuk ishin të afta në luftë, të mos humbisnin kohën kot por të vazhdonin, aq sa lejonin rrethanat, t'u jepnin mësim atyre që kishin kaluar moshën shkollore e që ishin analfabet në mënyrë që "... t'u japim pak dritë, e cila të ndriçojë mendjen prej padijes"⁴. Gjithashtu në qarkore tërhiqej vëmendja sidomos për punën që duhej bërë për regjistrimin në kurset kundër analfabetizmit, sidomos të të rinjve dhe të rejave që kishin mbushur moshën 15 vjeç.

¹ Ahmet Kondo, *Lufta kundër analfabetizmit në Shqipëri (1945-1955)*, Tiranë, 1973, f. 17.

² *Po aty*, f.23.

³ *Po aty*.

⁴ *Po aty*.

Siç dihet, në nëntorin e vitit 1944 zhvilloi punimet Kongresi Arsimor i Korçës, që përbënte një ngjarje të rëndësishme në jetën arsimore të vendit. Kongresi hodhi direktivat për një shkollë të re, duke shtruar si detyrë të veçantë dhe të rëndësishme edhe punën për zhdukjen e analfabetizmit. Ai doli me një vendim të prerë: “Asnjë analfabet në Shqipërinë e re demokratike”⁵. Realizimi i kësaj detyre mund të arrihej vetëm nëpërmjet mobilizimit të arsimtarëve të gjithë vendit për ngritjen e kurseve si dhe për pajisjen me arsim të asaj pjese të popullsisë, që sa kishte mësuar shkrim e lexim⁶.

Pas përfundimit të luftës, problemi i analfabetizmit u fut në kanale të organizuara si nga shteti, ashtu dhe nga organizatat që vepronin në atë kohë. *Periudha katërvjeçare 1945-1949 përbën fazën e parë të luftës masive për zhdukjen e analfabetizmit mbi baza vullnetare*. Dëshira e madhe e popullit tonë për t’u pajisur me arsim, ishte një faktor i rëndësishëm për organizimin e luftës kundër analfabetizmit duke garantuar pjesëmarrjen masive në kurset për të mësuar shkrim dhe këndim. Procesi në fillim mori tiparet e një lëvizjeje të fuqishme masive vullnetare, ku kontribuan veçanërisht organizatat politiko-shoqërore si Fronti Demokrat, Sindikatat, Bashkimi i Rinisë Komuniste dhe ai i Gruas shqiptare etj.

Veprimtaria e shtetit ishte e përqendruar kryesisht në nxitjen, përkrahjen, disiplinimin dhe organizimin e kësaj fushate⁷. Brenda strukturave të Ministrisë së Arsimit që nga viti 1946, u krijua Drejtoria e Arsimit Jashtëshkollor. Në funksionet e saj kryesore ishte ndërmarrja e masave për zhvillimin e sistemit arsimor si faktori bazë për mospërhapjen e analfabetizmit në moshat e reja. Përgatitja dora-dorës e kuadrit ligjor që do të garantonte në një të ardhme të afërt zgjidhjen e problemit për moshat e rritura, do të ishte një faktor tjetër parandalues për përhapjen e analfabetizmit.

Në rrethin e Fierit krahas hapjes së shkollave të reja fillore u organizuan kurse të shpejta, si një nga format kryesore për të luftuar analfabetizmin në qytet, në fshatra, në qendra pune e lagje, në aksione të ndryshme të rindërtimit, në repartet ushtarake etj. Sipas statistikave të kohës në vitin 1945, në shkallë vendi funksionuan 566 kurse me 10243

⁵ *I pari kongres i arsimtarëve*, në: “Bashkimi”, 25 dhjetor 1944.

⁶ Hamit Beqja, *Në themelet e arsimit tonë popullor*, Tiranë, 1976, f.27.

⁷ Eriketa Kambo, *Arsimi në Shqipëri (1945-1960)*, Tiranë, 2005, f.56.

pjesëmarrës, prej te cilëve 30% ishin femra⁸. Kurse në rrethin e Fierit funksionuan gjithsej 29 kurse, nga të cilat 4 në qytet, me gjithsej 413 pjesëmarrës, ku 286 ishin femra⁹. Drejtuesit e tyre u bënë njerëzit me kulturë, intelektualë të njohur të zonës, nxënës të shkollave të mesme, gra e të rinj vullnetarë me një farë arsimit, të cilët punuan me shumë pasion e dëshirë. Duke iu referuar statistikave lokale, vetëm në vitin 1946 numëroheshin 28 arsimtarë dhe 17 të rinj e të reja, që drejtuan me sukses kurset kundra analfabetizmit¹⁰.

Me kalimin e kohës u forcuan përpjekjet që kurset kundër analfabetizmit të merrnin karakterin e një shkolle. Organet qendrore të arsimit morën të gjitha masat e nevojshme nëpërmjet organizimit dhe kontrolleve në vazhdimësi, për mbarëvajtjen si dhe ecurinë e punës në kurset. Me krijimin e strukturave të posaçme në shkallë vendi, si Drejtoria e Arsimit Jashtëshkollor dhe komisionet qendrore, si dhe ato të ngritura në bazë qarku e prefekturë, u vunë bazat për një punë më të mirë organizative.

Seksioni i arsimit, organizatat shoqërore dhe masa e mësuesve në rrethin e Fierit punuan shumë me analfabetet për t'i bindur që të regjistroheshin dhe të ndiqnin kurset dhe shkolla. Si rezultat i punës së tyre të mirë, u hapën një numër i madh kursesh si në qytet, ashtu edhe në fshat. Gjithashtu, kurset u hapën edhe në ato fshatra që nuk kishin shkolla, ato ndihmoheshin nga personeli arsimor i shkollave të fshatrave më të afërta dhe në pamundësi nga elementët që kishin njohuri, por që merrnin udhëzime nga mësuesit e zonës.

Lufta kundër analfabetizmit erdhi duke u forcuar. Deri më 15 prill të vitit 1946, në fshatrat e Fierit numëroheshin 48 kurse gjithsej me 921 pjesëmarrës, nga të cilët 210 ishin femra. Numri i mësuesve që drejtonin kurset ishte 28 veta, kurse numri i të rinjve dhe të rejave që merreshin me drejtimin e kurseve në fshat të caktuar nga organizatat ishte 21 veta. Mësuan shkrim dhe lexim 238 veta, ku 39 ishin femra¹¹.

Si rregull, mësimi në kurset kundër analfabetizmit në përgjithësi zhvillohej në bazë të një programi dhe orari të caktuar. Në to punohej

⁸ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi 511, viti 1945, dos. L.K.A, nr.1, fl.1.

⁹ Arkivi Shtetëror Vendor i Lushnjës (më tej: ASHVL), Fondi 130, viti 1946, dos.79, fl.8.

¹⁰ Po aty, dos.33, fl.2.

¹¹ Po aty, fl.3.

edhe nga ana metodike për zhvillimin normal të mësimet, me qenë se një pjesë e mirë e drejtuesve të tyre ishin aktivistë të organizatave të masave. Kursantët pasi kishin mësuar shkrim dhe lexim, i nënshtroheshin provimit përpara një komisioni të përbërë prej mësuesit dhe prej një të deleguari të këshillit popullor të lokalitetit. Fituesve u dorëzohej një çertifikatë, me të cilën ata fitonin të drejtën për të vazhduar mësimet në gradën e parë të shkollës së natës.

Në fund të qershorit 1946, në rrethin e Fierit, funksionuan rreth 61 kurse kundër analfabetizimit pranë shkollave fillore. Pjesëmarrja në këto kurse në përgjithësi ishte e kënaqshme, u regjistruan 937 veta, prej të cilëve 391 ishin femra. Vazhduan rregullisht 621 kursantë (321) femra dhe 582 veta arritën të mësonin shkrim e lexim, nga të cilët 160 ishin femra¹². Është për t'u theksuar vullneti që i karakterizonte pjesëmarrësit në këto kurse, dëshira e tyre e madhe për të mësuar shkrim e lexim si dhe për të frekuentuar rregullisht mësimin, për të fituar dituri dhe arsim nëpërmjet shkollave të natës.

Me gjithë punën e mirë këmbëngulëse të pjesëmarrësve për arsimin, u vu re një dukuri negative që kishte filluar të shfaqej e të bëhej shqetësuese, mungonte bashkërendimi i duhur midis strukturave arsimore dhe organizatave të masave. Strukturat arsimore e konceptuan fillimisht si një çështje më tepër të organizatave shoqërore, duke u shndërruar shpesh në furnizuese "lapsash e fletorësh." Organizatat, nga ana tjetër, duke operuar me kategori të ndryshme të popullsisë bënë një punë të shkëputur. Parcelizimi i këtij problemi madhor si një dukuri e viteve të para, ndikoi negativisht në ritmet dhe për rrjedhojë edhe në rezultatet e tij¹³.

Në fillim të vitit 1947, në saje të një pune më të kujdesshme u bë e mundur që të vendoseshin kritere më të studiuara me Krijimin e Komisionit Qendror për Bashkërendimin e Luftës kundër Analfabetizimit, me funksionet e koordinatorit në shkallë vendi. Struktura e tij erdhi duke u plotësuar me ngritjen e komisioneve lokale fillimisht në qytetet kryesore, si Durrësi, Vlora, Fieri, Shkodra, Korça e më tej në qendrat më të vogla¹⁴. Komisioni Qendror ndërmori një proces riorganizimi të komisioneve lokale, forcoi kontrollin dhe rriti përpjekjet për

¹² *ASHVL*, Fondi 130, viti 1947, dos.53, fl.15.

¹³ E. Kambo, *vep. e përm.*, fl. 74.

¹⁴ *AQSh*, Fondi 511, viti 1947, dos.33, fl.1.

sensibilizimin e opinionit nëpërmjet shtypit. Vetë organet shtetërore tentuan të merren më shumë me problemet më të rëndësishme që lidheshin sidomos me rritjen e efikasitetit të kurseve. U shtuan afatet në 5 muaj dhe u përmirësuan programet. Sasia e orëve nga 120 arriti 160 dhe u bë më tepër kujdes në vlerësimin e kursantëve e dhënien e dëshmimeve¹⁵. Për rrjedhojë, nga pikëpamja sasiore, numri i atyre që përfituan u rrit. Kjo tregon se ishte fituar deri diku një përvojë që realisht ndihmoi për organizimin e një pune më të studiuar.

Më 1 shkurt 1947 kurset filluan nga puna si në qytet, ashtu edhe në fshatrat e Fierit. Në to, si në të gjitha kurset në shkallë vendi, jepeshin 6 orë mësim në javë. Zhvillohej këndim, shkrim dhe aritmetikë, sipas planit të orëve që parashikohej në “Programe e udhëzime për kurset me drejtuesit e kurseve për luftën kundra analfabetizmit”¹⁶. Programi përfshinte:

- “1. Udhëzime të përgjithshme për organizimin e mirë të kursit-3 orë.
 2. Udhëzime metodike për mësimin e shkrim-këndimit-15 orë.
 3. Udhëzime metodike për mësimin e matematikës -7 orë.
- Gjithsej 25 orë.”*

Si tekst përdorej një abetare e shtypur nga Ministria e Arsimit, posaçërisht për sektorin e arsimit për të rritur. Viti arsimor ndahej në dy fushata: dimërore dhe verore. Çdo kurs kishte mesatarisht 3-10 analfabetë dhe drejtohej nga mësues si dhe aktivistë të organizatave të ndryshme, si ato të Frontit, Rinisë, gruas etj.

Komisioni lokal për koordinimin e punës për zhdukjen e analfabetizmit në rrethin e Fierit shpallte gara me karakter lokal, në lidhje me numrin më të madh të kurseve e të analfabeteve që arrinte çdo lokalitet (lagje, qytet e fshat) në funksionimin dhe përparimin e tyre. Një nga format e përdorura ishte edhe organizimi i herëpashershëm i javës së luftës kundër analfabetizmit. Ky komision i bazuar në udhëzimet e Komisionit Qendror, prej 20-26 shkurtit të vitit 1947, shpalli programin e Javës së parë të luftës kundër analfabetizmit. Gjatë saj u bë një punë e mirë bindëse dhe me masat e popullit, veçanërisht me gratë dhe të rejtat shtëpiake, për t’u regjistruar në kurset dhe shkollat e natës. Nëpërmjet shtypit dhe afisheve u vu në dukje rëndësia e fushatës sidomos për rritjen e rolit të gruas në veprimtarinë shoqërore.

¹⁵ “Bashkimi”, 29 qershor 1948.

¹⁶ Po aty.

Me gjithë dobësitë e para, këto forma pune dhanë rezultate si në drejtim të shtrirjes së rrjetit të kurseve kundër analfabetizmit në të gjithë rrethin e Fierit, ashtu edhe në rezultatet e tyre. Kështu, gjatë fushatës së parë shkurt-mars-prill, të vitit 1947, u ngritën 98 kurse me 1978 veta, nga të cilat mësuan shkrim dhe këndim 1214 veta, prej të cilëve 613 gra e të reja¹⁷. Mësimi në këto kurse u zhvillua jo vetëm në shkolla, por edhe në shtëpi, me grupe prej 8-12 grash. Në kurset e gradës së parë morën pjesë gra krejt analfabete, ndërsa në ato të gradës së dytë, ato që dinin deri diku të shkruanin e të lexonin¹⁸.

Gjatë vitit 1948, për shkak se u fitua një përvojë më e mirë pune organizative dhe arsimore, lufta kundër analfabetizmit mori përmasa më të gjera dhe u vunë re rezultate disi më të mira në krahasim me vitet e kaluara. Fushata e re për regjistrimet në kurset kundër analfabetizmit filloi që në muajin tetor të vitit 1947, d.m.th. në një kohe më të përshtatshme dhe në kushte më të favorshme për regjistrimin e analfabetëve. Sipas një dokumenti të kohës, numri i pjesëmarrësve ishte në rritje. *“Më datën 13 mars 1948, në rrethin e Fierit, thuhej në të, funksionojnë 125 kurse me një numër të regjistruar 2353, nga të cilët 678 janë femra. Numri i drejtuesve në kurse ishte 112 veta, prej të cilëve 17 veta ishin arsimtar”*¹⁹.

Pak a shumë e njëjta situatë paraqitet edhe në Mallakastër. *“Gjatë muajit janar në zonën e Mallakastrës, theksohej në një tjetër dokument, kanë funksionuar 90 kurse kundra analfabetizmit ku janë regjistruar 1320 veta, prej të cilëve 700 janë meshkuj dhe 620 femra, vazhdojnë rregullisht 958 dhe përparojnë 461 veta. Në bazë të planit parashikohej që në fushatën e 2-të kundër analfabetizmit të mësonin 1000 veta dhe nga ana tjetër duhet të merren parasysh të rregulltit dhe del si përfundim se plani është realizuar 99,58% për muajin janar. Po të bëjmë një krahasim të gjendjes së kurseve, ato jo vetëm që janë shtuar, por edhe numri i të rregulltëve dhe të përparuesve është ngritur. Në këtë drejtim ka punuar mjaft organizata e frontit, anëtarët e së cilës drejtojnë pjesën më të madhe të këtyre kurseve... Një numër i këtyre kurseve janë hapur pranë shkollave, - vijohet në raport, - kështu që orenditë dhe mjetet e mësimi që disponojnë këto lihen të lira dhe përdoren për nevojat e kurseve, kurse*

¹⁷ ASHVL, Fondi 130.

¹⁸ “Bashkimi”, 22 janar 1947.

¹⁹ ASHVL, Fondi 130, viti 1948, dos. 47, fl.13-14.

pjesa tjetër punojnë nëpër banesa të ndryshme. Kështu që mungojnë orenditë dhe mjetet e mësimi... Personeli mësimor nëpër fshatra ka qenë i mjaftueshëm, por një numër i vogël i këtij personeli i la kurset dhe shkuan në kursin pedagogjik të Vlorës, dhe kurset që mbetën pa drejtues u zëvendësuan menjëherë”²⁰.

Duhet thënë se drejtuesit e kurseve punonin në kushte të vështira dhe jo të përshtatshme për zhvillimin normal të orës së mësimi. Megjithatë atyre nuk u mungoi vullneti dhe iniciativa për likuidimin e shpejtë të analfabetizmit. Ndërkohë shteti ofroi dhe një shpërblim simbolik prej 50 lekësh (sipas kursit të atëhershëm) për çdo kursant që mësonte studim e këndim. Më tej shpërblimi pësoi një farë rritje duke gjetur pasqyrim dhe në buxhetin lokal. Për çdo analfabet që mësonte të shkruante dhe të lexonte, shpërblimi për drejtuesit ishte 125 lekë. “Nga buxheti i shtetit për vitin 1948, në shkallë republike për prefekturat, qeveria shqiptare planifikoi fondin prej 4.787.500 lekë, prej të cilave shuma prej 2.170.000 lekësh i kalonte tremujorit të parë të vitit 1948. Gjithashtu u planifikua që për këtë vit do të mësonin shkrim e lexim në të gjithë vendin 38.300 veta”²¹.

Në planifikimin e fondeve të buxhetit të shtetit, për Prefekturën e Vlorës rezultoi se fondi i përgjithshëm për shpërblimin e personelit mësimor arrinte në 512.500 lekë (për tremujorin e parë 240.000 lekë). Nga këto 125.000 lekë në vit (për tremujorin e parë 55.000 lekë) i përkisnin Nënprefekturës së Fierit. Edhe për Nënprefekturën e Mallakastrës u planifikua për gjithë vitin, fondi në shumën prej 125.000 lekë dhe 60.000 lekë për tremujorin e parë. Për Prefekturën e Vlorës ishte planifikuar të mësonin shkrim e lexim 4100 analfabet, nga të cilët, përkatësisht 1000 veta i përkisnin nënprefekturave të Fierit dhe Mallakastrës²².

Puna për zhdukjen e analfabetizmit gjatë vitit 1948 gjeti pasqyrim të gjerë në organet e shtypit, të cilat dhanë ndihmesën e vet sidomos në përmirësimin e të metave dhe kalimin e pengesave që haseshin shpesh si gjatë fushatës së regjistrimeve, në frekuentimin e analfabetëve në kurset përkatëse, në punën metodike të drejtuesve etj.

²⁰ *Po aty*, viti 1947, dos.53, fl.18.

²¹ *Po aty*.

²² *Po aty*, viti 1948, dos.67, fl.8.

Problemi i analfabetizmit gjeti pasqyrim njëheri edhe në ligjin mbi planin e shtetit të vitit 1948. Mbi bazën e tij organet arsimore viheshin përpara detyrave të rëndësishme, ndër të tjera edhe për zhdukjen e analfabetëve në mënyrë të planifikuar. Në nenin 18 të këtij ligji thuhej: “*T’i jepet një rëndësi e veçantë luftës kundra analfabetizmit dhe për këtë qëllim të ngrihen 1780 kurse dhe të frekuentojnë ato 35.000 vetë*”²³. Gjithnjë sipas këtij plani për vitin 1948-1949, parashikohej që numri i kurseve në shkallë vendi të arrinte në 3820 dhe numri i analfabeteve që do të frekuentonin ato në 46700 veta. Për Fierin dhe Mallakastrën planifikohej që të ngriheshin 120 kurse të reja me 1200 pjesëmarrës²⁴.

Gjatë viteve 1945-1949 mësuan shkrim e lexim në të gjithë vendin 130.000 vetë, por mbeten analfabetë 420.000 të tjerë. Vetëm 50% e frekuentuesve arritën të merrnin dëshmitë përkatëse. Kurse për rrethin e Fierit “... nga kurset kundra analfabetizmit që janë çelur gjatë këtyre viteve, - citohet në një nga raportet e Seksionit të Arsimit, - kanë mundur të fitojnë 4811 vetë. Nga regjistrimi i përgjithshëm i bërë gjatë muajit qershor (1949-J.S) për këtë rreth rezultojnë të jenë 23925 analfabetë dhe gjysëm analfabetë 1645 vetë”²⁵.

Me gjithë përpjekjet që u bënë gjatë fazës së parë të Luftës Kundër Analfabetizmit, problemi vetëm sa u zbut. Mbetën ende analfabetë një sasi e konsiderueshme e moshave të afta për punë. Rezultatet e kësaj periudhe do të vazhdonin të kushtëzoheshin nga faktorë ekonomikë, kulturorë e social. Duhej ende shumë punë konkrete si në aspektin ligjor, ashtu edhe për emancipimin dhe ndërgjegjësimin e masave popullore.

2. Zhdukja e analfabetizmit në rrugë ligjore (1949-1955)

Në përpjekjet e bëra deri në vitin 1949, në rrethin e Fierit rreth 4000 vetë kishin përfunduar kurset kundër analfabetizmit dhe kishin mësuar të shkruanin e të lexonin. Duke marrë parasysh numrin ende të madh të analfabetëve, ritmet e zhdukjes së analfabetizmit ishin ende të ngadalshme. Viti 1949 shënoi një kthesë në këtë drejtim. Më 21 shtator 1949 u shpall dekret-ligji nr.227 mbi detyrimin e shtetasve për të mësuar shkrim dhe këndim deri në moshën 40 vjeç, i cili më 12 janar 1950 u

²³ Ligji mbi planin e shtetit të vitit 1948, në: gazeta “Bashkimi”, 11 janar 1948.

²⁴ ASHVL, Fondi 130, viti 1948, dos. 67, fl. 9-11.

²⁵ A. Kondo, *vep. e përm.*, fl.58.

ktheje në ligj²⁶, i cili gjeti pasqyrim edhe në planin dy vjeçar 1949-1950. Që nga ky vit, procesi vendoset mbi baza të rregullta ligjore. Në paragrafin e parë të ligjit thuhej:” *Se të gjithë shtetasit e Republikës që kanë plotësuar moshën 12 vjeç dhe nuk kanë kaluar të 40 vjetët, detyrohen të ndjekin kurset kundër analfabetizmit, në qoftë se nuk dinë shkrim dhe këndim*²⁷. Ai vinte përpara detyrimit të gjithë analfabetët deri në moshën 40 vjeç, nuk do të thoshte që të mos regjistroheshin në kurset kundër analfabetizmit edhe njerëzit mbi këtë moshë. Zbatimi në praktikë ishte një proces i gjatë dhe i vështirë që u kushtëzua jo vetëm nga rrethanat, kushtet dhe mundësitë e krijuara, por para së gjithash edhe nga vullneti dhe dëshira e vetë analfabetëve. Lufta kundër analfabetizmit tashmë kaloi nga faza e punës mbi baza vullnetare, në fazën e veprimit në rrugë të detyruar ligjore. Ligji vuri në lëvizje organet shtetërore dhe masën e gjerë të arsimitarëve dhe të aktivistëve të organizatave të masave për krijimin e kushteve të përshtatshme të punës në këtë drejtim. Kurset vijuan të hapeshin në lagje, në qendra pune, në aksione ndërtimi dhe në fshatra. Në këtë kuadër, organet e pushtetit lokal në rrethin e Fierit shtuan masat për sigurimin e bazës materiale të lokaleve dhe të drejtuesve të kurseve etj.

Për të bërë bilancin e ecurisë së këtij procesi në shkallë vendi, më 16 tetor 1949 u organizua Konferenca e I-rë Nacionale e Luftës kundër Analfabetizmit, e pasuar edhe nga ngjarje të tjera të rëndësishme, si Kongresi i II-të i Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë, që u mbajt nga 23-26 tetor 1949, Kongresi i II-të i Frontit Demokratik, më 7 mars 1950, si dhe Pleniumi VII-të i BGSH më 26 prill 1950, të cilat shtruan detyra të rëndësishme për zhvillimin e luftës kundër analfabetizmit. Strukturat shtetërore qendrore rritën përpjekjet për të siguruar kushtet e përshtatshme. Ato kërkojnë nga strukturat lokale, forcimin e kontrollit mbi punën mësimore në kurset kundër analfabetizmit dhe caktimin e drejtuesve të aftë e me përgatitje të mirë metodike për dhënien e mësimi, në mënyrë që kursantët të përfitonin më shumë dhe në kohën e duhur, në përputhje me kërkesat e programit mësimor. Në këtë mënyrë lufta kundër analfabetizmit, sidomos në masën e grave erdhi duke u forcuar edhe në rrethin e Fierit. Në saj të një pune intensive u shtua numri i kurseve dhe pjesëmarrësve në to. Nga 360 kurse me 4811 pjesëmarrës në vitin

²⁶ “Zëri i Popullit”, 18 tetor 1949.

²⁷ “Gazeta zyrtare”, 23 shkurt 1950, nr 8, Ligji Nr. 760, 12 janar 1950.

shkollor 1948-1949, numri i tyre në vitin 1949-1950 arriti në 420, me 5420 pjesëmarrës²⁸.

Lufta kundër analfabetizmit u konsiderua në këtë periudhë edhe si pjesë e procesit për emancipimin e gruas dhe një aksion i vështirë në luftë kundër së vjetrës dhe fanatizmit. Numri i grave dhe të rejave që mësonin shkrim dhe këndim u shtua nga viti në vit. Kështu, në fund të vitit 1950, në rrethin e Fierit ndoqën kurset kundër analfabetizmit 3064 gra dhe 1862 prej tyre e perfunduan atë me sukses, duke u pajisur me dëshmitë përkatëse²⁹.

Gjithashtu, lufta kundër analfabetizmit u pa edhe si pikënisje për shtimin e numrit të fuqisë punëtorëve të kualifikuar e të nevojshme në të gjithë sektorët e punës, në qytet dhe në fshatrat e Fierit. Në qendrat e punës, pasi u hartuan listat e analfabetëve dhe me miratimin e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, vetëm në vitin 1950 u ngritën dhe funksionuan 26 kurse me 529 pjesëmarrës, prej të cilëve 134 ishin femra³⁰.

Duhet vënë në dukje vështirësitë në ecurinë e kurseve, sidomos në ndërmarrjet bujqësore dhe ato blegtorale. Natyra e punës në këto sektorë sillte pengesa për një veprimtari të rregullt mësimorë, pasi i kushtohej më tepër vëmendje realizimit të planit për sigurimin e bukës dhe të produkteve blegtorale të domosdoshme për popullin. Puna e dobët në drejtim të evindentimit dhe mbajtjes së evidencave, si dhe krijimit të kushteve të përshtatshme për funksionimin e kurseve, që lidhej me largimin e punonjësve nga zonat kodrinore në ato fushore, si dhe nga fshati në drejtim të qytetit, ishin gjithashtu një tjetër faktor që ndikonte negativisht në luftën kundër analfabetizmit.

Gjatë vitit 1950, rezultate më të mira u arritën në radhët e rinisë. Strukturat e oraganizatave të rinisë i dhanë prioritet zhdukjes së analfabetizmit në radhët e rinisë së fshatrave, duke përdorur si metodë kryesore, format e patronazhit nga organizatat e rinisë të qendrave të punës. Vetëm gjatë tremujorit të parë të atij viti, mësuan shkrim e lexim 896 të rinj e të reja fierake³¹. Organizata e BRPSH-së në rrethin e Fierit dha një kontribut jo vetëm përsa i përket punës për zhdukjen e analfabetizmit në radhët e rinisë, por edhe për përgatitjen e shumë

²⁸ Po aty.

²⁹ "Bashkimi", 8 mars 1950.

³⁰ ASHVL, Fondi 130, viti 1950, dos.70, fl.9.

³¹ Po aty, dos.34, fl. 4.

drejtuesve të kurseve, duke u bërë kështu ndihmesë e afërt e seksionit të arsimit në rreth³².

Krahas realizimeve duhet thënë se gjatë zbatimit të ligjit mbi detyrimin e shtetasve për të mësuar shkrim e lexim deri në moshën 40-vjeç fillimisht u vërejtën të meta. Për periudhën 1951-1952 në rrethin e Fierit, parashikoheshin të hapeshin 441 kurse me nga 20 veta secili, sipas grup-moshave 12-25 vjeç dhe 26-40 vjeç. Realisht funksionuan 438 kurse me 4399 pjesëmarrës dhe në mbarim të kursit morën dëshminë 2188 kursantë. Sipas grup-moshave rezultonte se 2449 i përkisnin moshës 12-25 vjeç dhe 1950 ishin të moshës 26-40 vjeç³³, duke mos realizuar atë çka parashikohej “...regjistrimi i analfabetëve të moshës 11-40 vjeç nuk është kryer kudo dhe në rregull,- theksohej në raportin e Ministrisë së Arsimit, - ashtu edhe në regjistrimet në kurset, prandaj mungon një evidencë e lidhur e punës për likuidimin e analfabetëve në rreth e qytet. Seksioni i Arsimit duhet të shkundet nga kjo situatë, të marrin masa të menjëhershme dhe vazhdimësisë në punë me vrullin revolucionar që e karakterizon popullin dhe Shtetin tonë në fazën e parë të ndërtimit socialist të vendit”³⁴.

Ministria e Arsimit mbi bazën e një planifikimi të përgjithshëm hartoi një plan të detajuar mbi numrin e përgjithshëm të analfabetëve që do të mësonin në çdo rreth dhe për çdo vit. Për rrethin e Fierit parashikohej që për një periudhë 5-vjeçare të ngriheshin 1915 kurse me 20 veta secili, dmth do të regjistroheshin 38800 pjesëmarrës për të mësuar shkrim e lexim³⁵. Çdo lagje dhe çdo fshat ku do të ngriheshin kurset, hartuan listat e analfabetëve, siç parashikonte ligji. Pasi u aprovuan nga organet vartëse të pushtetit lokal, ato u afishuan 15 ditë para fillimit të kurseve. Ky kriter u ndoq me kujdes për të gjithë sektorët e punës, në qytet dhe në fshatra.

Ministria e Arsimit mori masa të shumta edhe për hartimin e teksteve, programeve dhe udhëzimeve metodike për një punë mësimore më të organizuar në kurset e analfabetizmit. Libri “Programe dhe udhëzime për kurset e analfabetizmit”, i botuar në këtë periudhë, ishte botimi i dytë pas abetares për të rritur dhe pas programit me 120 orë mësim, të botuar që në vitin 1947. Ai i shërbeu mjaft mësuesve dhe

³² *Po aty*, viti 1951, dos.7, fl.2.

³³ *ASHVL*, Fondi 130, viti 1952, dos.196, fl.3.

³⁴ “Puna”, 4 prill 1950.

³⁵ *ASHVL*, Fondi 130, viti 1952, dos.196, fl.6-9.

sidomos drejtuesve të kurseve kundër analfabetizmit në organizimin e punës së tyre. Programi përfshinte 160 orë mësim që zhvilloheshin gjatë një periudhe prej 20 javësh, i ndarë tetë orë mësim javor. Në disa raste sipas kushteve të vendit të punës, koha e vazhimit të kursit për zhvillimin e programit zgjatej edhe më tepër, derisa të plotësoheshin 160 orë mësimi. Pasi caktohej orari i përjavshëm i mësimëve, shtrohej nevoja e respektimit të tij si përsa i përkiste sasisë së orëve të mësimimit, ashtu edhe të kohës së fillimit dhe mbarimit të mësimëve. Çdo orë mësimi zgjaste 50 minuta³⁶.

Gjatë orës së mësimimit, kursantët lexonin pa ndërprerje dhe me kuptim një pjesë këndimi, duke dhënë edhe kuptimin e brendisë në formë të thjeshtë, shkruanin pa gabime një pjesë të lehtë që u diktohej dhe shfaqnin me shkrim lirisht mendimet e tyre. Në lëndën e gjuhës përfshihej njohja e shkronjave të shtypit e të dorës dhe mësimi i shkrimit mirë e bukur. Në lëndën e aritmetikës, kursantët mësonin numrat deri 1.000, katër veprimet në numrat e plotë deri në 100 si dhe mbledhje, zbritje e shumezim deri në 1.000, peshat dhe masat.

Kongresi II i PPSH, i cili i zhvilloi punimet më 31 mars 1952 dhe Konferenca e II-të e Arsimitarëve, që u mbajt në Tiranë më 7 shtator 1952, analizuan zhvillimet e deriatëhershme në këtë fushë. Mbi bazën e saj u arrit në përfundimin se me gjithë masat e marra e rezultatet e arritura, ritmet e këtij procesi duhej të përshpejtoheshin. Niveli i analfabetizmit në shkallë vendi mbetej i lartë. Për këtë qëllim u dha orientimi që pesëvjeçari i parë të kthehej në një periudhë pune më të madhe për zhdukjen e analfabetizmit deri në vitin 1955³⁷.

Në saj të punës së bërë, ishin krijuar disa rrethana më të favorshme. Kishte dalë një ligj që i detyronte shtetasit deri në moshën 40 vjeç që të mësonin shkrim e lexim, ishte fituar një përvojë pozitive nga pikëpamja organizative dhe ekzistonte vullneti dhe dëshira e madhe e asaj mase analfabete që vazhdonte me zell mësimet për të mësuar shkrim e lexim etj. Në vitin shkollor 1952-1953 në të gjithë vendin u zbatua për të parën herë arsimit 7-vjeçar i detyrueshëm me ligj, që u aprovua në qershor të vitit 1952³⁸. Kjo qe një masë e rëndësishme parandaluese për likuidimin e analfabetizmit tek të rinjtë. Ligji mbi detyrimin e arsimit fillor, përfshinte

³⁶ A. Kondo, *vep. e përm.*, f.78.

³⁷ H. Beqja, *vep. e përm.*, f.94.

³⁸ “Arsimi popullor”, viti 1952, nr.7.

pa asnjë përjashtim të gjithë fëmijët e moshës përkatëse dhe në të gjitha shkollat, pavarësisht nga rrethanat dhe vështirësitë e hasura. Ai detyronte organet shtetërore që të merrnin “masa të cilat duhet të jenë të rrepta kundër atyre prindëve, që për një arsye ose një tjetër, pengojnë fëmijët e tyre të venë në shkollë”³⁹.

Në këto kushte edhe në rrethin e Fierit në bashkëpunim me organizatat e masave, përpjekjet për shtimin e pjesëmarrjes në kurset dhe shkollat profesionale të punëtorëve u forcuan. Vetëm gjatë vitit shkollor 1952-1953, mësuan shkrim e lexim 4863 të rinj e të reja analfabete ose gjysmëanalfabet⁴⁰. Ky fakt tregonte se analfabetizmi në radhët e rinisë po vinte duke u ulur.

Viti shkollor 1953-1954 përbënte një periudhë të rëndësishme për zgjidhjen e këtij problemi. Organet drejtuese të pushtetit lokal të Fierit, duke ndjerë përgjegjësinë shtetërore dhe shoqërore, rritën kujdesin për përmirësimin e punës në kurse, të cilësisë së tyre dhe shkallës së përfitimit të pjesëmarrësve. Kështu, gjatë kësaj periudhe në të gjithë rrethin funksionuan rregullisht 476 kurse me 7616 analfabetë, prej të cilëve 3016 ishin femra. Në këtë kuadër u përdorën forma të reja organizative, si krijimi i aktiveve të rinisë dhe të gruas me aktivistë e aktiviste të përgatitur për zhdukjen e analfabetizmit, apo pajisjen e analfabetëve me kartela personale, mbajtjen e evidencave të rregullta etj. Rezultatet erdhën duke u rritur. Në shtator të vitit 1955, numri i kursantëve që mësuan shkrim e lexim arriti në 417 veta⁴¹.

Më 20 maj 1956 nga tribuna e Kongresit III të PPSH, udhëheqja komuniste deklaroi se në Shqipëri analfabetizmi deri në moshën 40 vjeç ishte likuiduar, kurse Seksioni i Arsimit i Fierit me shkresën nr. 10/14, datë 21.11.1956 drejtuar Ministrisë së Arsimit e Kulturës, do të theksonte se: “ *Analfabetizmi është zhdukur në 82 fshatra*”⁴². Në të vërtetë analfabetizmi nuk u likuidua në ato përmasa që u deklarua. Kështu, gjatë vitit shkollor 1956-1957 edhe në rrethin e Fierit vazhdonte të kishte analfabetë të moshës nën 40 vjeç. Sipas statistikave të kohës rezultonte se ishin regjistruar 1117 kursantë, prej të cilëve vetëm 312 veta vazhdonin rregullisht kurset për të mësuar shkrim e lexim⁴³.

³⁹ Po aty.

⁴⁰ ASHVL, Fondi 130, viti 1953, dos. 121, fl.2.

⁴¹ Po aty, viti 1955, dos.26, fl.14.

⁴² Po aty, viti 1956, dos. 223, fl.8.

⁴³ Po aty, viti 1957, dos.87, fl.2.

Arsyet ishin të njëjta si për ecurinë e gjithë këtij procesi në shkallë vendi, por ne do të ndalemi në ato më kryesoret. Shkollimi i rregullt dhe kurset ishin forma kryesore nëpërmjet të cilave analfabetët mësuan shkrim e lexim. Por, siç edhe trajtuam, veçanërisht kurset, nuk e arritën efikasitetin e duhur. Duke funksionuar me fushata dimërore dhe verore nuk u sigurua dot vijimësia. Si organet shtetërore, ashtu edhe organizatat shoqërore e ulnin dhe e ngrinin interesin, në varësi të trysnisë së strukturave më të larta. Fenomeni i mosruajtjes së raporteve të duhura midis parimit të vullnetarizmit dhe zbatimit të ligjit ishte i pranishëm edhe në rrethin e Fierit. Mania e realizimit me çdo kusht “të planit” i nxiti shpesh organet arsimore në përpilimin e listave, ku u përfshinë edhe elementë me interesa të pakta për të mësuar. Shumë shpejt ata i braktisnin kurset, duke ulur efektshmërinë e tyre⁴⁴.

Mangësitë e bazës materiale didaktike, ndryshimi i shpeshtë i afateve të kurseve dhe sidomos programet e pakonsoliduara, ishin gjithashtu një pengesë. Kujtojmë se fillimisht ato parashikonin 120 orë, më tej 160 orë dhe së fundi deri në 300 orë. Po kështu, kohëzgjatja e kurseve varionte nga disa javë, në 4 muaj, 5 e 7 muaj duke mos garantuar nivelin e duhur të përvetësimit të shkrimit e të leximit. Të gjitha këto ndikuan jo pak në shkallën e qëndrueshmërisë së njohurive të përfituara. Tepër veprues ishin edhe faktorët subjektivë. Realisht, analfabetët e moshave më të reja duke pasur më shumë energji dhe dëshirë, kishin të tjera shanse në raport me moshat e tjera. Për shkak të mentalitetit, mundësitë e pjesëmarrjes në kurse ishin më të kufizuara në gratë apo të rejtat kundrejt meshkujve etj. Patriarkalizmi i prindërve ishte mjaft i fortë. Kurset për gra e të reja ishin të pakta edhe në rrethin e Fierit. Ishin këto arsye që kurset shpesh edhe në zona të zhvilluara vepruan të ndara, veç për burrat dhe veç për gratë apo të rejtat.

Jo pa rëndësi në arritjen e rezultateve ishte edhe niveli i drejtuesve. Kur ishin mësues, problemi ishte më i thjeshtë, pavarësisht se edhe një pjese të tyre fillimisht u mungonte eksperiencia e duhur. Por për të përballuar përmasat e këtij procesi u përfshinë elementë joprofesionistë, madje ata përbënin shumicën. Në rastin më të mirë ata kishin disa klasë arsim të mesëm apo 7-vjeçar, por pjesa më e madhe e tyre ishin me arsim fillor, shpesh jo të plotë. Kjo e ulte rezultatin.

⁴⁴ E. Kambo, *vep. e përm.*, f.74.

Duhet theksuar fakti, se një pjesë e kursantëve, pavarësisht se kishin një dëshmi të fituar, me kalimin e viteve e humbën gradualisht aftësinë e shkrimit e të leximit, për rrjedhojë u krijua një analfabetizëm “i fshehtë”. Siç është edhe theksuar në studime të tjera për këtë problem, ai njihet si fenomen, por realisht nuk gjeti pasqyrim në statistikat zyrtare. Për këtë arsye me të drejtë mendohet që numri i vërtet i analfabetëve ishte më i madh dhe përgjithësisht i atyre që përfituan mbetet i diskutueshëm⁴⁵.

Në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë për rrethin e Fierit, niveli i analfabetizmit në vite ndryshoi sipas tabelës së mëposhtme:

Tab. 1⁴⁶

Vitet	Popullsia	Analfabete	Përqindja e analfabetizmit mbi popullsinë		
			Në përgjithësi	Mbi meshkujt	Mbi femrat
1945	51951	40729	78,4	64,7	86,2
1950	72789	41344	56,8	43,3	68,5
1955	92268	11802	26,3	24,3	38,6

Duke iu referuar statistikave të periudhës 1945-1955, vërehet një ulje e konsiderueshme e numrit absolut të analfabetëve, veçanërisht pas vitit 1950. Në shkallë rrethi, nga 40729,5 analfabetë në vitin 1945, rezultojnë si të tillë në vitin 1955, rreth 11802. Nëpërmjet kurseve mësuan shkrim dhe lexim përafërsisht 19469 persona⁴⁷. Nëpërmjet sistemit të shkollave mësuan shumë analfabetë të moshave të reja. Këtë e provon edhe fakti se, gjatë viteve 1945-1955 në arsimin fillor hynë 10630 nxënës të rinj, kryesisht shumica e tyre u takon klasave të para në uljen e nivelit të tij të përgjithshëm.

Pas vitit 1955, si në të gjithë vendin edhe në Fier, niveli i analfabetizmit ulet me ritme më të ngadalshme, gjë që shpjegohet me dy arsye. *Së pari*, sistemi shkollor është zgjeruar deri diku në nivele të kënaqshme. Kjo pengoi procesin e krijimit të analfabetëve të rinj. *Së dyti*,

⁴⁵ *Po aty.*

⁴⁶ *ASHVL*, Fondi 130, viti 1960, dos.16, fl.3.

⁴⁷ *Po aty.*

si rrjedhojë e masave të ndërmarra, shumica e analfabetëve deri 40 vjeç, morën bazat e shkrim-leximit. Në vitin 1956, problemi i analfabetizmit deri në moshën 40 vjeç, zyrtarisht u konsiderua i mbyllur. Por në shkallë vendi ai mbeti çështje e pazgjidhur për rreth 13,7% të grupmoshës 12-25 vjeç dhe respektivisht, për 6,8% të meshkujve dhe 19,4% të femrave të kësaj moshe. Pavarësisht nga kjo, deri në këtë periudhë u arritën rezultate të konsiderueshme⁴⁸. Kuptohet që edhe në shkallë lokale, fenomeni ishte i pranishëm.

Si përfundim, mund të thuhet se arritjet ishin një vepër dhe kontribut i të gjithë popullsisë, veçanërisht i intelektualëve që punuan me përkushtim për të përçar dritën e diturisë dhe kulturës në vend. Ato ishin rezultat edhe i kontributit që dhanë mjaft kuadro arsimor fierake që drejtuan luftën kundër analfabetizmit gjatë periudhës 1945-1955, si: Perikli Ikonomi, Jovan Gjergo, Llamba Ikonomi, Dhimitri Kola, Thoma Shkurti, Beqir Sinojmeri, Bejas Meço, Urani Naçi, Sotiraq Xoxa, Dafina Koliçi, Jorgji Dhimitri, Kristina Plaka etj.

Me gjithë përpjekjet që u bënë gjatë periudhës 1945-1955, ecuria e mëtejshme e ngjarjeve provoi se për shumë vite, shoqëria fierake ashtu si gjithë shoqëria shqiptare vazhdoi të përballej me analfabetizmin “e fshehtë” tek një pjesë e moshave të afta për punë, gjë që nuk gjeti asnjëherë pasqyrim në të dhënat e publikuara nga strukturat partiake dhe shtetërore të kohës, duke mbajtur rezerva për një periudhë gati 50-vjeçare.

S u m m a r y

THE FIGHT AGAINST ILLITERACY IN THE DISTRICT OF FIERI (1945-1955)

At the end of the WWII as consequence of the deep social-economical inherited backwardness Albania had high levels of illiteracy. The obliteration of the illiteracy for the largest part of the population in the area of Fieri, as well as in most of the country, it underwent through two phases. The first phase

⁴⁸ E. Kambo, *vep. e përm.*, f.78-79.

during 1945-1949 was characterised mainly by a volunteer movement under the supervision of the state.

The second phase (1949-1955), it was the period in which the problem was solved mainly through the legislative approach.

In the district of Fieri, alongside with the opening of elementary schools since 1945 were organised brief courses as main format to fight illiteracy. A major contribution gave the teachers, the intellectuals and the organisations of the masses by transforming it in a large interregional action. The process went through a number of difficulties such as the lack supervisors, venues, and teaching materials and foremost the existence of the conservative mentality that prevented the participation of the girls and women in the courses. During the first phase, with all the efforts that were taken the problem was only alleviated. While, the major developments, were witnessed during the second phase, after the laying down the law "On the obligation of the citizens to learn how to write and read" in 1949. The legislative decision and the organisation it created a favourable environment for the resolving of the problem. At the end of the period taken in consideration 19.469 illiterates had learned how to write and read compared to 40.729 that were in 1945.

In difference with the official declaration that considered the problem as resolved since 1955 the later events showed the opposite. For many years Fieri community in the same way as the Albanian society continued to be faced with the hidden illiteracy at least for a part of the working population something that was never reflected in the published data by the party or state structures of that time.